**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME**

## SPECIFIKIME TEKNIKE PËR SECILIN ARTIKULL OBJEKT PROKURIMI,

Në zbatim të urdhërit me Nr. 73 datë 06.05.2026 për llogaritjen e fondit limit, dhe specifikimeve teknike për zhvillimin e proçedurës së prokurimit me objekt “Blerje dyer të brendshme për institucionin ARRSH qendër”, për vitin 2026 me qëllim realizimin e detyrave funksionale dhe objektivat e autoritetit, më poshtë po ju vendosim në dispozicion specifikimet teknike

## II. SPECIFIKIME TEKNIKE

- **Dyer të brendshme**

1. Dera të jetë e tipit **tamburat**, e destinuar për ambjente të brendshme.
2. Fleta e derës të ketë trashësi **jo më pak se 40 mm.**
3. Struktura e brendshme të jetë me **bërthamë honeycomb (karton alveolar)** ose ekuivalente, e përforcuar me drunë pjesët e menteshave dhe bravës.
4. Korniza (kasa) të jetë prej **druri të tharë industrialisht** ose MDF me rezistencë të lartë, e pershtatshme për montim në mure me trashësi sipas projektit.
5. Siperfaqja e derës të jetë e veshur me:

    - Rimeso natyrale, ose
    - CPL/HPL, ose
    - MDF e lyer me bojë poliuretani,

    sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
6. Sipërfaqja të jetë rezistente ndaj konsumimit, gërvishtjeve, lagështisë së zakonshme të ambienteve të brendshme dhe rrezeve UV.
7. Të gjitha skajet e derës të jenë të mbyllura dhe të mbrojtura kundër depërtimit të lagështisë.
8. Dera të pajiset me:

    - 3 (tre) mentesha metalike të rregullueshme
    - bravë cilindrike (ose bravë për ambiente të brendshme)
    - doreza prej alumini ose inoksi
    - kundërpllakë dhe të gjithë aksesorët e nevojshëm për funksionim.
9. Kasa të jetë e kompletuar me :
    - listela mbuluese nga të dyja anët

- guarnicion gome për amortizimin e mbylljes
- të gjithë elementët e fiksimit

10. Hapja e derës (majtas ose djathtas) të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor gjatë porosisë
11. Ngjyra të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor nga katalogu standard i prodhuesit.
12. Dimensionet standarde orientuese:
13. Devijimi dimensional i lejuar të jetë sipas standardeve përkatëse të prodhimit dhe montimit.
14. Dera duhet të hapet dhe mbyllet pa deformime, fërkime apo zhurma të pazakonshme.
15. Të gjitha materialet të jenë të reja, të papërfunduara dhe pa defekte vizuale ose mekanike.
16. Furnizuesi të kryejë:
    - matjen në objekt
    - transportin
    - montimin
    - rregullimin përfundimtar
    - pastrimin e mbetjeve pas montimit
17. Garancia minimale të jetë 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim.
18. Produkti duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane për dyer të brendshme dhe prodhuesi/furnizuesi të paraqesë dokumentacionin teknik përkatës (deklaratë performance ose dokument ekuivalent, sipas legjislacionit në fuqi).